




BULETINI



KORRIK/GUSHT 2023



Takimi i ZYRËS së BNJ të UNMIK-ut dhe OJQ-ve: Adresimi i shqetësimeve për të drejtat e njeriut në veri të Kosovës

Më 23 gusht, OJQ ACDC organizoi një takim ndërmjet z. Jerome Bouyjou, Shef i Zyrës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut dhe Përfaqësues i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, dhe OJQ-ve nga veriu i Kosovës, për të diskutuar zhvillimet e vazhdueshme në veri të Kosovës dhe krizat politike mbizotëruese me ndikim në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Përfaqësuesit e OJQ-ve ngritën çështje të tilla si prania e policisë speciale, besimi midis banorëve, ndalimi i produkteve serbe, mungesa e ushqimit dhe siguria e shkollave. Po ashtu, theksuan rritjen e numrit të personave që largohen nga Kosova, për shkak të krizave të zgjatura politike dhe të sigurisë. Z. Bouyjou theksoi se Zyra për të Drejtat e Njeriut do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e institucioneve dhe shoqërisë civile për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe veriu të Kosovës.




Nënshkruhet vazhdimi i kontratës me përkthyesit dhe bashkëpunëtorët ligjor

Drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, ka nënshkruar vazhdimin e kontratës me katër përkthyes dhe pesë bashkëpunëtorë ligjor në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Ata do të vazhdojnë të ndihmojnë gjyqtarët në pastrimin e lëndëve të pazgjidhura dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura. Përkthyesit dhe bashkëpunëtorët ligjorë janë të angazhuar përmes OJQ ACDC në projektin e financuar nga UNMIK-u; "Mbështetja e qasjes në drejtësi në veri të Kosovës", i cili synon të avancojë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.



Publikim i ri – Hulumtim mbi bashkëpunimin ndëretnik në Zveçan

Në kuadër të projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në vetëqeverisjen lokale", i financuar nga National Endowment for Democracy (NED), dhe i implementuar nga OJQ ACDC, në muajin korrik është publikuar analiza e titulluar "Rritja e bashkëpunimit ndëretnik në Zveçan". Hulumtimi i realizuar në Komunën e Zveçanit kishte për qëllim vlerësimin e perceptimit të komuniteteve në këtë zonë lidhur me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik. Hulumtimi është i disponueshëm në faqen e internetit të ACDC në të tri gjuhët.



Këtë verë, OJQ ACDC ka nisur një fushatë në mediat sociale që vë në pah faktorët e nxitur nga njerëzit që kontribuojnë në vërshimet, si shpyllëzimi rreth lumenjve, nxjerrja e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, asgjësimi i rastësishëm i mbetjeve dhe ndërtimi i ndërtesave përreth lumenjve. Nëpërmjet kësaj fushate, ne synojmë të rrisim ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm që luajnë veprimet njerëzore në përkeqësimin e çështjeve të vërshimeve, duke promovuar përfundimisht praktika të përgjegjshme mjedisore për një të ardhme të qëndrueshme.

Në muajt e fundit, ACDC ka genë e angazhuar në mënyrë aktive në nxitjen e diskutimeve mbi të drejtat e njeriut dhe çështjet shoqërore në Kosovë.

Nëpërmjet një serie Op-Ed-ësh, jo vetëm që u kemi dhënë mundësinë të rinjve të shprehin perspektivat e tyre, por gjithashtu theksuam rëndësinë thelbësore të të drejtave të njeriut në shoqërinë e sotme.

Artikujt kanë mbuluar një sërë temash jetike duke përfshirë shpronësimin e tokës në veri të Kosovës, Sfidat në arsim, shëndetësi dhe drejtësi, të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtat mjedisore, të drejtat gjuhësore, të drejtën për lirinë e lëvizjes, të drejtat LGBTIQ+, ndihmë juridike falas, dhe tema të tjera që lidhen me konceptin e të drejtave të njeriut. Këto tekste u botuan në kuadër të projektit të financuar nga CDF, që synon të përmirësojë kushtet për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke promovuar të kuptuarit dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut, të menduarit kritik, qytetarisë aktive dhe vlerave universale të të drejtave të njeriut përmes fushatave të mediave sociale dhe Op-Ed-ëve.

ACDC do të vazhdojë këtë iniciativë me botime për të promovuar ndërgjegjësimin dhe avokimin për të drejtat e njeriut.



Zërat e Rinisë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë - Nga Shpronësimi i Tokës tek të Drejtat e LGBT+





I gjithë programi mbështetet nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social, dhe me përfshirjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal së Republikës së Kosovës, së bashku me Fondin për Zhvillim të Komunitetit (CDF).

Vazhdimi i projektit M4Y

Ndikimi i projektit po zgjerohet në 15 komuna në Kosovë, duke e rritur më tej shtrirjen e tij. ACDC do të vazhdojë të mbikëqyrë këto komuna: Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Graçanicë dhe Fushe Kosovë.

Projekti M4Y, i mbështetur nga Fondi Japonez për Zhvillim Social dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe i udhëhequr nga Banka Botërore, synon të fuqizojë të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç në Kosovë duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive në zhvillimin e komunitetit.

Projekti i ri - Rritja e punësueshmërisë së komuniteteve serbe dhe boshnjakes



Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e punësimit në tregun e punës në veri të Kosovës përmes fuqizimit të të rinjve. Ky synim do të arrihet përmes fuqizimit të të rinjve për të qenë më konkurrues në tregun e punës.

Ky projekt mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Republika Federale e Gjermanisë.

Pjesëmarrje në takime dhe ngjarje të ndryshme



OJQ ACDC së bashku me përfaqësues të tjerë nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) me prejardhje të ndryshme etnike në Kosovë dhe Organizata e Komuniteteve Ndërkombëtare në partneritet me Community Building Mitrovica (CBM), u mbledhën për të eksploruar mënyrat e mundshme për fuqizimin e përpjekjeve për ndërtimin e paqes në Kosovë.

OJQ ACDC gjithashtu iu bashkua një diskutimi me gazetarë, profesionistë të mediave dhe përfaqësues të OJQ-ve nga komunitetet e ndryshme në Mitrovicën e Jugut mbi përfaqësimin, portretizimin dhe sigurinë e grave në mediat lokale, organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.



Për më tepër, OJQ ACDC mori pjesë në një sesion informues mbi 'Ngritjen e efikasitetit të fondeve përmes edukimit financiar', organizuar nga CBM.

•Gjatë një debati të fundit në Qendrën Mediale në Çagllavicë, Aleksandar Rapajiq theksoi se situata në Kosovë është përkeqësuar ndjeshëm pas largimit të serbëve nga institucionet e Veriut.




Shenimi i Ditëve Ndërkombëtare

OJQ ACDC vazhdon të respektojë ditë të ndryshme ndërkombëtare që kanë rëndësi në promovimin e ndërgjegjësimit dhe vlerave globale.



OJQ ACDC u shfaq në faqen e internetit të Këshillit të Evropës në lidhje me një nga projektet tona që synonte të promovonte mosdiskriminimin. Për informata më të detajuara rreth projektit, mund të vizitoni faqen zyrtare të Këshillit të Evropës.



ACDC in Media

·Zyrtarja e Programit të ACDC-së, Ines Aljovic Mihajlovic për të drejtat e punës së grave



·Zyrtarja e Programit të ACDC-së, Ines Aljovic Mihajlovic në emisionin "Prindërimi në praktikë" në RTK 2, duke diskutuar ndikimin e shtatzënisë dhe kujdesit ndaj fëmijëve tek punëdhënësit.



·Drejtori Ekzekutiv i ACDC, Dushan Radaković për Kosovo Online rreth tërheqjes së policisë në veri.



·Drejtori Ekzekutiv i ACDC, Dushan Radaković për mbylljen e Telekomit në veri të Kosovës



·Drejtori i Programit të ACDC, Aleksandar Rapajiq për Kosovo Online për anëtarësimin e Komunës së Mitrovicës së Veriut në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

